



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr.2264/6 Prot

Tiranë, më 21.11.2024

VENDIM

Nr.31, datë 21.11.2024

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9/1, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, z. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 2264 Prot., datë 23.10.2024, saktësuar me e-mail-in datë 25.10.2024, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale/Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, në cilësinë e kërkuesit, nëpërmjet kërkesës me datë 08.10.2024, depozituar në adresën elektronike eduart.dedej@shendetesia.gov.al, ka kërkuar t’i vihet në dispozicion informacioni/dokumentacioni, në lidhje me:

1. Raportin vjetor të Komisionit për Mbrojtjen nga Rrezatimi për vitin 2016;
2. Raportin vjetor të Komisionit për Mbrojtjen nga Rrezatimi për vitin 2017;
3. Raportin vjetor të Komisionit për Mbrojtjen nga Rrezatimi për vitin 2018;
4. Raportin vjetor të Komisionit për Mbrojtjen nga Rrezatimi për vitin 2019;
5. Raportin vjetor të Komisionit për Mbrojtjen nga Rrezatimi për vitin 2020;
6. Raportin vjetor të Komisionit për Mbrojtjen nga Rrezatimi për vitin 2021;
7. Raportin vjetor të Komisionit për Mbrojtjen nga Rrezatimi për vitin 2022;
8. Raportin vjetor të Komisionit për Mbrojtjen nga Rrezatimi për vitin 2023.

Autoriteti Publik, me-mail-in datë 08.10.2024, ka përcjellë për kompetencë dhe trajtim, pranë Zyrës së Mbrojtjes nga Rrezatimet, kërkesën për informacion të sipërcituar.

Bazuar në pikën 2 të nenit 15 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, (në vijim “LDI”), “Kur autoriteti publik që merr kërkesën për informim ia dërgon atë një autoriteti tjetër, ai kthen përgjigje jo më vonë se 15 ditë pune nga dita e mbërritjes së kërkesës në autoritetin e parë”.

Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet me e-mail-in datë 21.10.2024, ka kthyer përgjigje duke bërë me dije se: “... Kërkuesi duhet të saktësojë se cili është informacioni publik, i cili përbën interes për të, sepse Raporti Vjetor i ZMR/KMR përmban informacione për të dhëna personale apo tregtare të subjekteve fizike dhe juridike që trajtohen në bazë të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2028 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar. Pasi të jetë saktësuar informacioni, kërkesa do të përcillet KMR si organ vendimmarrës që të shprehet në lidhje me këtë çështje”.

Ankuesi, pas përgjigjes së sipërcituar, pretendon se: “...raportet e ZMR/KMR janë raporte publike periodike, të cilat ZMR-ja e ka për detyrë ti publikojë, gjë e cila nuk ndodh prej vitit 2013 në faqen e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe në faqen e Institutit të Shëndetit Publik. Në radhë të dytë, një nga arsyet që paraqet ZMR-ja nuk ka bazë ligjore pasi në raport nuk gjenden informacione për të dhëna personale apo tregtare të subjekteve fizike e juridike sepse emri i kompanisë apo subjektit nuk është e dhënë personale...”. Në këto kushte, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, i është drejtuar Zyrës së Komisionerit, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit, si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e dokumentacionit të kërkuar.

Zyra e Komisionerit pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, në përputhje me përcaktimet e nenit 24 të LDI.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: “Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur”, Komisioneri, me shkresën nr. 2264/2 prot., datë 28.10.2024, ka kërkuar nga Autoriteti Publik të informohet mbi trajtimin apo procedurën e ndjekur lidhur me kërkesën për informacion, brenda datës 04.11.2024.

Autoriteti Publik me shkresën nr. 499/1 prot., datë 04.11.2024, administruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 2264/3 prot., datë 06.11.2024, ka kthyer përgjigje duke argumentuar ndër të tjera se: “... Së pari, Në email kthim përgjigje të ZMR, datë 21.10.2024 nuk është refuzuar informacioni nga ZMR për vendosjen në dispozicion të raporteve të KMR, por bazuar në nenin 17 dhe 15 pika 3/c e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i është bërë me dije të saktësojë konkretisht çfarë informacioni publik (pjesë e raporteve të

KMR/ZMR) përbën interes për të, sepse ky dokument përbën të dhëna sensitive dhe personale për subjektet dhe si e tillë, kërkesa për informacioni do t'i përcillet Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet për trajtim, si autoriteti vendimmarrës dhe që administron këtë dokument. Së dyti, sqarohet se Komisioni Mbrojtjes nga Rrezatimet nuk ka detyrim ligjor publikimin e Raporteve Vjetore të KMR nuk publikohen prej vitit 2013, për shkak të të dhënave apo informacionin që përmbajnë këto raporte, në lidhje me burimet radioaktive, informacion të cilin nuk mund ta ketë kushdo. Mbështetur në ligjin 8853, datë 31.1.2002 për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën ndërkombëtare për mbrojtjen fizike të materialeve bërthamore” si dhe ligjit nr. 88/2013 për ratifikimin e ndryshimeve të konventës “Për mbrojtjen fizike të materialeve bërthamore”, parimi themelor i tyre është konfidencialiteti. Gjithashtu, mbështetur në sa më sipër përcaktohet se shteti duhet të vendosë kërkesa për mbrojtjen e konfidencialiteti të informacionit, zbulimi i paautorizuar i të cilit mund të cenonte mbrojtjen fizike të materialeve dhe/ose impianteve bërthamore.

Në këtë kuadër me miratimin e VKM nr. 877, datë 30.10.2015 “Për sigurimin e burimeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë”, e cila ka për qëllim sigurimin e burimeve radioaktive nga aktet keqbërëse si vjedhja, zhvendosja e paautorizuar e burimeve radioaktive dhe sabotimi i instalimeve radioaktive, autoriteti rregullator KMR vlerëson se të gjithë personat që do të kenë akses në përdorimin dhe/ose informacion për burimet radioaktive kategoria 1,2 dhe 3, të kalojnë fillimisht në program verifikimi nga strukturat e Policisë së Shtetit. Kjo me qëllim sigurim fizik të burimeve radioaktive dhe uljen e kërcënimit në nivel lokal e kombëtar. Procesi i verifikimit të besueshmërisë dhe përshtatshmërisë së personave rregullohet me marrëveshjen e bashkëpunimit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me Ministrinë e Brendshme me nr.4730 prot., datë 2.10.2019 për MSHMS dhe me nr. 7933/1 prot., datë 11.10.2019 për MB, e cila në nenin 1 pika 2 dhe nenin 2 pika 1, përcakton se: personat që do të kenë akses në informacionin, i cili lidhet me të dhënat e burimeve radioaktive apo vendndodhjen ku ato ruhen, transportohen, përdoren duhet t'i nënshtrohen një programi verifikimi për besueshmërinë dhe përshtatshmërinë nga strukturat e Policisë së Shtetit. KMR/ZMR në zbatim të marrëveshjes, dërgon zyrtarisht në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, listën emërore me të dhënat përkatëse, të personave, për të cilën është i nevojshëm verifikimi i besueshmërisë dhe përshtatshmërisë.

Në zbatim sa më sipër, si dhe duke vlerësuar se Raporti i KMR përmban të dhëna për llojin e burimeve radioaktive dhe subjektet që i kanë në përdorim ose ruajtje, KMR/ZMR nuk mund ta dërgojë këtë informacion tek personat që nuk kanë fillimisht programin e verifikimit nga Policia e Shtetit. Duke vlerësuar se një pjesë e informacionit që përmbajnë Raportet Vjetore të KMR/ZMR preket nga kufizime ligjore, gjykojmë se me saktësimin konkretisht të informacionit publik nga kërkuesi, KMR/ZMR në mbështetje të nenit 17 pika 6 e ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” do t'i vendosë në dispozicion atë pjesë të informacionit, i cili nuk preket nga këto kufizime”.

Ndërkohë, Autoriteti Publik/Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me shkresën nr. 4485/1 prot., datë 05.11.2024, administruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 2264/4 Prot., datë 08.11.2024, ka përcjellë për kompetencë dhe trajtim, shkresën nr. 2264/2 prot.,

datë 28.10.2024 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pranë Zyrës së Mbrojtjes nga Rrezatimet.

Ankuesi, pas përgjigjes së Zyrës së Mbrojtjes nga Rrezatimet ka vijuar ankimin, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 2264/5 prot., datë 11.11.2024 duke argumentuar ndër të tjera se: *“...Interesi im parësor është shumë i thjeshtë, mbrojtja e shëndetit personal, familjar dhe publik, gjithmonë duke qenë i informuar me fakte për mbetjet e rrezikshme, mënyrën se si menaxhohen ato dhe të gjitha kategoritë e ndryshme të mbetjeve të rrezikshme, ku edhe institucioni juaj ka rolin e vet. Në kërkesën time për informacion kam kërkuar raportet zyrtare publike të Zyrës së Mbrojtjes nga Rrezatimi, që deri në vitin 2012 kanë qenë të publikuara në faqen zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale...*

Ju flisni për ligjin nga fillimi deri në fund të letrës tuaj, por nuk sqaroni se çfarë është ndryshuar në ligjin e ri dhe çfarë neni i këtij ligji (përsëri nuk e specifikoni ligjin) e ndalon institucionin që ju drejtoni në mënyrë specifike të publikojë pjesë nga raportet zyrtare për të cilat ju vet deklaroni, që mund të vendosen në dispozicion. Në të njëjtën letër, ju flisni për një marrëveshje të pa publikuar me Ministrinë e Brendshme, të cilën nuk ma keni treguar si dokument të publikuar në faqen tuaj zyrtare apo te Qendra e Botimeve Zyrtare dhe e mbyllni me kaq sqarimin ndërkohë që institucionet publike funksionojnë sipas ligjit.

E kuptoj që ka specifika të veçanta për çështjet që lidhen me sigurinë kombëtare, por përsëri nuk e lidhni në mënyrë specifike ligjin me pjesën që mund të publikohet.

E fundit, por që është parësore, puna ime si gazetar hulumtues fillon me vlerësimin e fakteve dhe të dhënave që gjenden në raportet zyrtare publike të institucioneve publike, për të shkuar më pas te analiza e këtyre fakteve nëse kemi apo jo devijime në ligj duke marrë asistencë dhe dëshmi nga ekspertët e fushës dhe personat që kanë evidentuar shkeljet nëse ka patur. E përsëris, interesi im lidhet me sigurinë shëndetësore dhe me çështjen e mbetjeve radioaktive nëse kemi patur, nëse ka patur subjekte që kanë shkelur ligjin në menaxhimin e këtyre mbetjeve dhe çfarë masash keni ndërmarrë ju si institucion ndaj këtyre subjekteve dhe a është zbatuar ligji në këtë rast”.

Pas konsultimit të legjislacionit të posaçëm, dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ dhe qëndrimit të mbajtur nga Autoriteti Publik, Komisioneri vlerëson se argumentet e parashtruara për ankesën objekt shqyrtimi, nuk janë në përputhje me dispozitat dhe parimet e LDI.

Në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 2 të LDI parashikohet se: *“Autoritet publik” është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësisve të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj”.*

Në kuptim të këtij parashikimi, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale/Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Lidhur me argumentin e parashtruar nga Autoriteti Publik se, “...bazuar në nenin 17 dhe 15 pika 3/c e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i është bërë me dije të saktësojë konkretisht çfarë informacioni publik (pjesë e raporteve të KMR/ZMR) përbën interes për të, sepse ky dokument përbën të dhëna sensitive dhe personale për subjektet dhe si e tillë, kërkesa për informacioni do t’i përcillet Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet për trajtim, si autoriteti vendimmarrës dhe që administrojnë këtë dokument”, Komisioneri vlerëson se ky argument është i gabuar.

Konkretisht, bazuar në pikën 1 të nenit 12 të LDI në të cilës parashikohet se: “Në rastet kur autoriteti publik, të cilit i drejtohet kërkesa për informim, është i paqartë në lidhje me përmbajtjen dhe natyrën e kërkesës, ai kontakton menjëherë, por gjithnjë jo më vonë se 48 orë nga data e paraqitjes së kërkesës, me kërkuesin për të bërë sqarimet e nevojshme. Në çdo rast, autoriteti publik ndihmon kërkuesin në saktësimin e kërkesës”, Autoritetit Publik i jepet mundësia që në rastet kur është i paqartë mbi informacionin e kërkuar, të kërkojë saktësimin e tij, te kërkuesi. Rezulton që kjo procedurë e kryer nga Autoriteti Publik nuk qëndron edhe pse në vlerësim të Komisionerit objekti i kërkesës për informacion është mëse i qartë.

Ndërkohë, LDI rregullon dhënien e aksesit në informacionin publik për çdo person të interesuar. Ky ligj, në nenin 17 të tij gjithashtu përcakton dhe rastet kur dhënia e informacionit jepet në mënyrë të kufizuar. Në këto raste, Autoriteti Publik duhet të tregojë qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që refuzohen, si dhe në bazë të cilës pikë të nenit 17 bëhet ky refuzim. Konstatohet se, Autoriteti Publik nuk ka argumentuar mosvënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar të bazuar në rastet e parashikuara për kufizim sipas nenit 17 të LDI, si dhe nuk ka bërë një analizë të mirëfilltë, apo të argumentojë, se si kjo e drejtë kufizohet, kur është e domosdoshme, proporcionale, si dhe dëmin që mund t’i shkaktojë çdo personi fizik ose juridik, subjekt i licensuar në bazë të ligjit nr. 8025, datë 9.11.1995 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese” i ndryshuar, dhe ligjit nr. 10469, datë 13.10.2011 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese” i ndryshuar, si pasojë e dhënies së dokumentacionit të kërkuar.

Po ashtu, bazuar në pikën 1 të nenit 3, Ligji nr. 9887/2008 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i ndryshuar, (në vijim “Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, parashikohet: “Të dhëna personale” është çdo informacion në lidhje me një person fizik, të identifikuar ose të identifikueshëm, direkt ose indirekt, në veçanti duke iu referuar një numri identifikimi ose një a më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor apo social. Në këtë kuadër, emrat e subjekteve të regjistruar si person fizik ose juridik në bazë të legjislacionit përkatës tregtar, nuk konsiderohen si të dhëna personale dhe si të tilla nuk gëzojnë mbrojtje nga ky ligj. Ndërkohë, “Të dhëna sensitive” në kuptim të pikës 4 të nenit 3 të ligjit të sipërcituar është çdo informacion për personin fizik, që ka të bëjë me origjinën e tij, racore ose etnike, mendimet politike, anëtarësimin në sindikata, besimin, fetar apo filozofik, dënimin penal, si dhe të dhëna për shëndetin dhe jetën seksuale. Në rastin tonë, kërkesa për informacion konsiston në vendosjen në dispozicion të Kopje të Raporteve Vjetore të Komisionit për Mbrojtjen nga Rrezatimi, të cilat nuk përmbajnë

elementë të përfshira në parashikimin si më sipër. Rezulton se, Autoriteti Publik nuk ka argumentuar mos dhënien e informacionit mbi këtë dispozitë.

Lidhur me argumentin e parashtruar nga Autoriteti Publik se: “... Mbështetur në ligjin 8853, datë 31.1.2002 për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën ndërkombëtare për mbrojtjen fizike të materialeve bërthamore” si dhe ligjit nr. 88/2013 për ratifikimin e ndryshimeve të konventës “Për mbrojtjen fizike të materialeve bërthamore”, parimi themelor i tyre është konfidencialiteti. Gjithashtu, mbështetur në sa më sipër përcaktohet se shteti duhet të vendosë kërkesa për mbrojtjen e konfidencialiteti të informacionit, zbulimi i paautorizuar i të cilit mund të cenonte mbrojtjen fizike të materialeve dhe/ose impianteve bërthamore”, Komisioneri vlerëson se nuk përputhet me objektin e kërkesës për informacion

Parimi i konfidencialitetit në Konventën për Mbrojtjen Fizike të Materialeve Bërthamore (CPPNM) synon të mbrojë informacionin sensitiv dhe kritik që lidhet me sigurinë bërthamore, duke parandaluar që ky informacion të bjerë në duar të gabuar, por kurrsesi ky parim nuk duhet të pengojë transparencën dhe përgjegjshmërinë e institucioneve publike, si Komisioni për Mbrojtjen nga Rrezatimet, të bëjë publike Raportet Vjetore detyrim i cili buron në bazë të pikës 10 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 123, datë 5.3.2014 “Për ngritjen, përbërjen dhe mënyrën e organizimit, të funksionimit e të shpërblimit të Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet” sipas të cilit: “KMRR-ja miraton çdo vit raportin vjetor për sigurinë dhe sigurimin e burimeve të rrezatimit jonizues dhe jojonizues në Republikën e Shqipërisë, të përgatitur nga Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet në bashkëpunim me institucione të tjera të fushës”.

Në këto rrethana, Komisioneri vlerëson se, informacioni/dokumentacioni i kërkuar në parim përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të LDI, sipas të cilit “informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”. Rrjedhimisht, ekzistenca e informacionit/dokumentacionit të mësipërm pavarësisht nëse ai është i prodhuar apo administrohet nga Autoriteti Publik, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit, për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar. Në këto kushte Autoriteti Publik duhet të vendosi në dispozicion të kërkuarit informacionin e kërkuar, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit të sipërcituar, sipas të cilës: “Nëse kufizimi prek një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”.

Informacioni i kërkuar konsiston në vendosjen e Raporteve Vjetore të Komisionit për Mbrojtjen nga Rrezatimet dhe bërja publik e tyre paraqet interes të lartë për publikun, pasi lidhet me sigurinë publike dhe shëndetin e njerëzve, duke rritur kështu besimin e publikut të institucionet që merren me sigurinë bërthamore dhe mbrojtjen nga rrezatimet.

Si përfundim, Komisioneri thekson se, LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, transparencës e përgjegjshmërisë së autoriteteve publike dhe çdo subjekti që ushtron funksione publike. Ndërkohë pika 3, e nenit 3 e LDI parashikon se: “Çdo person ka të drejtë

të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”.

Gjithashtu, ankuesi është gazetar, i cili synon informimin e opinionit publik mbi çështje lidhur me funksionimin e autoriteteve publike, duke i shërbyer në këtë mënyrë interesit të lartë publik. Ky qëndrim i Komisionerit, gjen mbështetje në jurisprudencën e GJEDNJ-së, e cila në çështjen “Társaság a Szabadságjogokért kundër Hungarisë”, vlerësoi se, pengesat e krijuara, të cilat vështirësojnë aksesin në informacion me interes publik, mund të dekurajojnë punonjësit e medias, ose në fusha të ndërlidhura me të, të realizojnë punën e “mbikëqyrësit shoqëror”, duke zvogëluar mundësitë e tyre për të ofruar informacione të sakta dhe të besueshme.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën c), të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës nr. 2264 Prot., datë 23.10.2024, saktësuar me e-mail-in datë 25.10.2024, nga z. _____, kundër Autoritetit Publik, “Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet”, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit të kërkuar sipas kërkesës për informacion datë 08.10.2024, duke respektuar kufizimet, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të LDI, konkretisht: “- *Kopje të Raportit vjetor të Komisionit për Mbrojtjen nga Rrezatimi për vitet 2016 - 2023*”, brenda datës 06.12.2024.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 21.11.2024.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi